




# VLERËSIMI I KATËRT I HARMONIZIMIT TË SHËRBIMEVE DHE MJETEVE EKZISTUESE PUBLIKE DIGJITALE ME LIGJIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE



maj 2023



Ky projekt është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.

Zbatuar nga Fondacioni 'Metamorfozis' në partneritet me 'Konekt'.

METAMORPHOSIS  
Fondacion për internet dhe shoqëri

KONEKT

**Autor: Gjorgji Rajçinoski**

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit "Mbrotjtja teknike dhe e integruar e të dhënave personale – ndërtimi i një ekosistemi inkluziv digjital", të përkrahur nga Bashkimi Evropian, ndërsa i realizuar nga Fondacioni Metamorfozis dhe Shoqata Kontekt. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Fondacionit Metamorfozis dhe e autorëve; dhe në asnjë mënyrë nuk i reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.

## PËRMBAJTJA

METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E PËRPUTHSHMËRISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE DIGJITALE NGA INSTITUCIONET QEVERTARE NË MAQEDONINË E VERIUT ME LIGJIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

..... 3

VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE DIGJITALE ME LIGJIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

..... 4

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET NË ASPEKT TË PROGRESIT TË REALIZUAR GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

.....7

# **1. METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E HARMONIZIMIT TË SIGURIMIT TË SHËRBIMEVE DIGJITALE NGA ANA E INSTITUCIONEVE QEVERITARE NË MAQEDONINË E VERIUT ME LIGJIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Vlerësimi i katërt i harmonizimit të shërbimeve të siguruara digjitale nga institucionet qeveritare me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (në tekstin e mëtejme: LMDHP), për periudhën shkurt-maj, 2023, bëhet si vazhdimësi e vlerësimeve të realizuara paraprake.

Analiza dhe vlerësimi bëhet në bazë të një metodologjie të përgatitur dhe të shfrytëzuar paraprakisht, si dhe konkluzioneve dhe rekomandimeve të dhëna nga autorët me qëllim të monitorimit të rezultateve dhe ndryshimeve të bëra nga ana e institucioneve qeveritare.

Qëllimi kryesor i hulumtimit është vlerësimi i progresit të ofrimit të shërbimeve digjitale dhe harmonizimit të tyre me LMDHP.

Dallimi i vetëm i qasjes metodologjike gjatë përpilimit të kësaj analize ka të bëjë me atë që mbledhja e të dhënave gjatë kësaj analize është bërë vetëm përmes monitorimit online, respektivisht analizimit të ueb faqeve dhe aplikacioneve online ku ofrohen shërbimet digjitale në bazë të parametrave të vendosura me metodologjinë.

## 2. VLERËSIMI I HARMONIZIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE

### DIGJITALE ME LIGJIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Kontrollori	Shërbimi digjital	Përkufizimi i shërbimeve digjitale dhe qasja e tyre	Transparenca e përpunimit të të dhënave personale	Masat e parapara teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale	Vlerësimi i përgjithshëm
<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>	Caktimi i terminëve për dokumente personale (letërnjoftim, pasaporta, patenta shoferi)	4/5	5/8	2/6	11/19
<b>Ministria e Financave</b>	E-shërbime	2/5	4/8	5/6	11/19
	E-obligime	2/5	3/8	3/6	8/19
	E-qarkore	3/5	1/8	3/6	7/19
	E-ankande	3/5	1/8	3/6	7/19
	FAMA	1/5	1/8	2/6	4/19
	Sistemi elektronik për paraqitjen e detyrimeve	3/5	2/8	3/8	8/19
	E-aktgjykime	2/5	0/8	1/6	3/19
<b>Drejtoria Doganore</b>	Sistem i ri i kompjuterizuar tranzitues	1/5	0/8	2/6	3/19
	Sistem për përpunimin e deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizave	4/5	6/8	4/6	14/19
	EXIM	3/5	0/8	3/6	6/19
	Ambient i integruar i tarifave	2/5	0/8	1/6	3/19
	Portal për komunikim elektronik	1/5	3/8	3/6	7/19
<b>Drejtoria e të Ardhurave Publike</b>	Shërbime elektronike për tatimpaguesit	4/5	1/8	3/6	8/19
	Shërbimi elektronik për paraqitjen e tatimit personal	3/5	1/8	3/6	7/19
	Ankande elektronike	4/5	2/8	2/6	8/19
	Kthim i TVSH-së	4/5	4/8	3/6	11/19
<b>Drejtoria e Zbulimit Financiar</b>	Dorëzimi i raporteve në DZF	3/5	2/8	4/6	9/19
	Ueb platformë restriktive	4/5	4/8	3/6	11/19
<b>Drejtoria e Policisë Financiare</b>	Denonco vepër penale	4/5	7/8	4/6	15/19
<b>Ministria e Drejtësisë</b>	Baza e ligjeve, akteve nënligjore dhe rregullave të tjera	2/5	0/8	3/6	5/19

<b>Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë</b>	E-portali për lëshimin e certifikatave nga librat amë	4/5	2/8	5/6	11/19
<b>Byroja për Ekspertizë Gjyqësore</b>	Kërkesë për shërbim – ekspertizë, vlerësim, analizë profesionale	4/5	1/8	1/6	6/19
<b>Ministria e Transportit dhe Lidhjeve</b>	e-leje: leje për ndërtim, ndërtim shtesë dhe mbindërtim; kërkesë për ndryshime gjatë ndërtimit; kërkesë për ndryshimin e investuesit, kërkesë për dhënien e lejes për përdorimin e ndërtimit; kërkesë për dhënien e lejes për rikonstrukcion; Kërkesë për lëshimin e lejes për ridedikim; kërkesë për lëshimin e lejes për adaptim; kërkesë për leje për punë përgatitore; kërkesë për miratimin e projektit ideor dhe kërkesë për lëshimin e aktvendimit për realizimin e ndërtimeve për të cilat nuk nevojitet leje për ndërtim.	4/5	2/8	4/6	10/19
<b>Këshilli Inspektues</b>	Parashtresë për punën e një inspektori	5/5	6/8	2/6	13/19
<b>Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm</b>	Parashtresa online	4/5	7/8	2/6	13/19
<b>Ministria e Ekonomisë</b>	E-koncesione	5/5	4/8	3/6	12/19
	E-ankande	3/5	0/8	2/6	5/19
<b>Inspektorati Shtetëror i Tregut</b>	Denoncime nga qytetarë	4/5	7/8	2/6	13/19
<b>Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik</b>	Formular Online për kontakt	4/5	7/8	2/6	13/19
<b>Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë</b>	E-shërbime:	4/5	8/8	2/6	14/19
	Kërkesa fitosanitare	4/5	8/8	2/6	14/19
	Eksperti i verës	4/5	8/8	2/6	14/19
	Certifikatë për kualitet	/	/	/	Shërbimi nuk është i disponueshëm
	Përcaktimi i kushteve	4/5	8/8	2/6	14/19

<b>Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës</b>	Sistemi për menaxhim me mësimin	2/5	2/8	2/6	6/19
<b>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale</b>	Aplikacion në celular për denoncimin e dhunës	3/5	0/8	1/6	4/19
<b>Inspektorati Shtetëror i Punës</b>	Parashtrimi i parashtresës nga person fizik ose juridik dhe parashtresa anonime	4/5	6/8	2/6	12/19
<b>Ministria e Arsimit dhe Shkencës</b>	Sistem informatik për porosi dhe shpërndarje të librave falas	2/5	0/8	2/6	4/19
<b>Byroja për Zhvillimin e Arsimit</b>	Platforma online për zhvillim të hershëm të fëmijëve për edukatorë, mësimdhënës klasor dhe prindër	4/5	0/8	3/6	7/19
<b>Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor</b>	<a href="http://www.uslugi.piom.com.mk">www.uslugi.piom.com.mk</a>	4/5	1/8	2/6	7/19
<b>Fondi i Sigurimit Shëndetësor</b>	<a href="https://fzo.org.mk/pristap-web-portal-e-uslugi">https://fzo.org.mk/pristap-web-portal-e-uslugi</a>	4/5	4/8	3/6	11/19
<b>Ministria e Drejtësisë</b>	<a href="http://www.vakcinacija.mk">www.vakcinacija.mk</a>	4/5	5/8	5/6	14/19
	<a href="#">MK Wallet</a>	3/5	5/8	3/6	11/19
<b>Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive</b>	<a href="http://OSSP(katastar.gov.mk)">OSSP (katastar.gov.mk)</a>	4/5	5/8	4/6	13/19
	<a href="#">I-kat aplikacioni mobil</a>	3/5	0/8	1/6	4/19
<b>Ministria e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor</b>	<a href="https://ewmis.moep.gov.mk/">https://ewmis.moep.gov.mk/</a>	0/5	0/8	3/6	3/19

### 3. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET NË ASPEKT TË PROGRESIT TË REALIZUAR GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Në bazë të rezultateve të fituara dhe krahasimit me raportin paraprak, mund të vijmë deri te një konkluzion i përgjithshëm se institucionet nuk kanë përparim të posaçëm në procesin e harmonizimit, krahasuar me rezultatet e raportit paraprak.

Mund të konstatohet se institucionet shtetërore në pjesë të caktuara mund t'i përmirësojnë lehtësisht rezultatet e tyre sipas parametrave të dhënë.

Si shembuj pozitivë (veçanërisht kur do t'i krahasojmë edhe rezultatet e vlerësimeve të mëparshme) mund të theksohen Ministria e Financave, Drejtoria e Doganave, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Drejtoria e Zbulimit Financiar, megjithëse në vlerësimin paraprak kanë pasur nota të larta, treguan përparim dhe rezultate më të mira gjatë vlerësimit në këtë periudhë.

Gjithashtu, Drejtoria e Policisë Financiare dhe Këshilli Inspektues u vlerësuan për herë të parë, mirëpo treguan edhe shkallë të lartë të harmonizimit.

Përparim më i madh është vërejtur edhe te Ministria e Punëve të Brendshme (nga 4/19 në 11/19) dhe ajo është para se gjithash falë rritjes së notave në "përkufizimin e shërbimeve digjitale dhe disponueshmërisë së tyre" dhe "transparencën e përpunimit të të dhënave personale" që është sinjal i shkëlqyeshëm si bazë që mund të përsoset edhe më tutje.

Shqetëson fakti që ende ka shërbime të cilat kanë notë më të vogël se 10/19 edhe për ato institucione që i mundësojnë shërbimet për ndihmë adekuate.

Nëse ndaj këtij vlerësimi bëjnë analizë në aspekt të temave të vlerësuara, mund të konstatojmë si vijon:

Për pjesën "**Përkufizimi i shërbimeve digjitale dhe disponueshmëria e tyre**" konstatohet se institucionet edhe pse për pjesën më të madhe të shërbimeve të tyre digjitale kanë bazë ligjore për përpunimin e të dhënave personale, të njëjtat nuk e përkufizojnë atë në mënyrë të mjaftueshme, veçanërisht duke mos i publikuar edhe rregullat që janë relevante për atë përpunim, si dhe se nuk i publikojnë detajet për përpunim që bëhen nga ana e përpunuesve, e që ekziston gjasë e madhe se janë angazhuar përpunues në pjesën më të madhe të institucioneve.

Pozitive në këtë pjesë është që një pjesë e madhe e këtyre institucioneve publikojnë udhëzime për shfrytëzimin e shërbimeve të veta.

Kur bëhet fjalë për pjesën "**Transparenca e përpunimit të të dhënave personale**", mund të thuhet se paraqet ndoshta pikën më të dobët në sistemet për mbrojtjen e të dhënave personale të institucioneve.

Pjesa më e madhe e institucioneve pothuajse nuk kanë publikuar informata adekuate në lidhje me përpunimin e të dhënave, e edhe më të rrallë janë ata që e theksojnë afatin e ruajtjes së të njëjtave.

Gjithashtu, këto institucione që kanë publikuar informata të caktuara, dokumentacione dhe të ngjashme, shpeshherë i vendosin në vende që nuk janë të lehta për t'u parë dhe t'u qasur.

Gjatë vlerësimit të **“Masave të parapara teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale”**, më e dukshme është mospublikimi i Procedurës/ Metodologjisë për realizimin e vlerësimit të ndikimit në bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Edhe pse për këtë nuk ekziston obligim decid për publikim publik, do të ishte një praktikë e mirë që i njëjti të publikohet, si dhe të publikohen Vlerësimet e realizuara ose së paku një Raport për të njëjtat. Këtu parashtrohet pyetja se sa prej institucioneve e shfrytëzojnë këtë mundësi që e jep LMDHP.

Duke marrë parasysh përparimin e kufizuar në procesin e harmonizimit me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, në këtë raport konstatojmë se mbeten në fuqi të gjitha konkluzionet dhe rekomandimet paraprake, me çka në mënyrë shtesë do të konstatohen konkluzionet për arsyet që konsiderohen se nuk kanë arritur përparim të madh në pjesën e harmonizimit me ligjin.

**Përparimi i kufizuar mund të jetë rezultat i disa faktorëve, edhe atë:**

**KONKLUZIONI 1:** Institucionet që në ueb faqet e tyre kanë theksuar Politikën e privatësisë dhe biskota, të dhënat për oficerin për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe dokumentet e tjera që ndikojnë në transparencën, si dhe ligjshmërinë dhe realizimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, nuk e mundësojnë të njëjtën edhe për nëndomenet në ueb faqen e tyre (p.sh: në ueb faqen [www.finance.gov.mk](http://www.finance.gov.mk) kanë publikuar Politikën e privatësisë, por jo edhe në nëndomenin <https://e-trezor.finance.gov.mk/eobvrski/home.seam;>)

**REKOMANDIMI 1:** Institucionet që kanë ueb faqe prej të cilave dalin nëndomene, në mënyrë adekuate duhet ta trajtojnë edhe pjesën e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe t'i publikojnë të gjitha informatat e nevojshme, përfshirë edhe udhëzimet për shfrytëzim, procedurat adekuate etj.

**KONKLUZIONI 2:** Politikën e privatësisë/skedarët më së shpeshti nuk i përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe nuk i përfshijnë shërbimet që mundësohen përmes ueb faqes.

**REKOMANDIMI 2:** Përditësimi i përmbajtjeve të ueb faqeve (përfshirë edhe nëndomenet) me qëllim për t'i përmbajtur të gjitha informatat e nevojshme.

**KONKLUZIONI 3:** Është i dukshëm mosinvestimi në kapitalin njerëzor edhe atë: zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale në shumë situata, fillimisht punojnë edhe detyra tjera (edhe pse ideja e ligjit është që zyrtari të realizojë punë të tjera shtesë, nëse ka mundësi të tillë); edukim i pamjaftueshëm i tyre; mospasje të mundësisë (platformë të caktuar) për ndarjen e përvojave;

**REKOMANDIMI 3:** Institucionet të cilat kanë vëllim më të madh të përpunimit të të dhënave personale, më shumë aktivitete për përpunimin e të dhënave personale, nevojitet të sistematizojnë vend pune – Zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale, në pozitë që do të jetë e pavarur dhe e mëvetësishme dhe do të përgjigjet drejtpërdrejtë para udhëheqësisë më të lartë.



Gjithashtu, LMDHP parasheh mundësinë e angazhimit me Kontratë për realizimin e shërbimeve, që jep mundësi që ndonjë institucion apo disa institucione të mund të angazhojnë person me njohuri dhe aftësi përkatëse për të realizuar të gjitha obligimet e punës.

**KONKLuzioni 4:** Mosinteresim dhe mospasje të vetëdijes nga ana e udhëheqësisë së institucioneve në lidhje me këtë temë, megjithëse për një pjesë të institucioneve në të kaluarën janë publikuar informata për çrregullime të caktuara të sigurisë së të dhënave personale (ueb faqe, aplikacione dhe sisteme të hakuara, etj.)

**REKOMANDIMI 4:** Komunikimi i raportit dhe aktivitet më të madh të sektorit joqeveritar në detektimin dhe analizë të thelluar të sistemeve për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht të atyre institucioneve që mundësojnë më shumë shërbime digjitale.

**KONKLuzioni 5:** Gjatë realizimit të kësaj analize, është konstatuar se ndodh që shërbime të caktuara të jenë përkohësisht pa qasje, e disa edhe tërësisht të shkyçura.

**REKOMANDIMI 5:** Mundësimi i masave përkatëse teknike dhe organizative për sigurimin e sigurisë së të dhënave personale, me qëllim të mundësimin të vazhdimësisë së shërbimeve dhe përjashtimit të shërbimeve jofunksionale.

**KONKLuzioni 6:** Në lidhje me përdorimin e skedarëve (“cookies”), është konstatuar se një pjesë e institucioneve nuk sigurojnë pëlqim paraprak për shfrytëzimin e skedarëve nga ana e shfrytëzuesit të ueb faqes.

**REKOMANDIMI 6:** Mundësimi i pëlqimit paraprak me mundësi për pranimin dhe refuzimin e shfrytëzimit të skedarëve.